



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 3274 Prot.

Fier, më 17.03.2025

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak

Drejtuar: ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË FIER
PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53 pika 4 , nenit 56 pika 2, shkronja “a”, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar , ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Fier në sallën e këshillit ditën e **Enjte datë 27.03.2025 në orën 12:00** me këtë rend dite:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë **27.02.2025**
3. **Projekt – vendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Shkurt 2025”
4. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e Raportit për Vlerësimin dhe Parashikimin Afatmesëm të të Ardhurave 2026-2028
5. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028” të Bashkisë Fier
6. **Projekt – vendim:** “Për shpërndarjen e 3 banesave sociale me qira, të cilat rezultojnë të lira nga menaxhimi i banesave sociale me qira pranë bllokut të Banësive Sociale Lagja “16 Prilli” Fier, për 3 familje të pastreha”
7. **Projekt – vendim:** “Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Selim Stafa, fshati Baltëz, Njësia Administrative Dërmënas , për dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga zjarri i datës 10.03.2025”
8. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e pagesës së shpenzimeve të varrimit të Znj Bukurie Metua.”
9. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2030”, për Bashkinë Fier.

10. Diskutime dhe komente

Kryetar Këshilli

Antoneta Cunaaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK FIER
KRYESIA

Nr.

Fier në 17.03. 2025

VENDIM NR. 23 DATË 17.03.2025

PËR MIRATIMIN E RENDIT PARAPRAK TË DITËS PËR MBLEDHJEN E DATËS

Kryesia e Këshillit Bashkiak Fier në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 27 datë 15.04.2020 “ Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak, rregullores për Konsultimet Publike dhe Kodin e Sjelles për funksionimin e Këshillit”, Kreu 2, neni 22 “Kryesia e Këshillit “ neni 1, 3, 4

VENDOSI:

1-Miratimin e Rendit paraprak të Ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet në datën 27.03.2025 . Bashkëlidhur këtij vendimi gjenden pikat e Rendit paraprak të Ditës.

2-Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak për publikimin e njoftimit të Rendit të Ditës, si dhe njoftimin e Këshilltarëve, Kryetarit të Bashkisë dhe çdo personi tjetër të interesuar për pjesëmarrje në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

3-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYESIA E KËSHILLIT

1-Antoneta Çunaj

2-Endri Jaupaj

3-Fatbardha Merkaç

4-Evis Sema

5-Kreshnik Dapi

6-Arben Çuko